

## **Takimi rajonal i komponentëve të AFP-së dhe Agjencive të sigurimit të cilësisë për cilësinë e të mesuarit me bazë punën**

Takimi rajonal i EQET SEE VET dhe Agjencive të sigurimit të cilësisë për zhvillimin e rekomandimeve dhe mjeteve për vlerësimin e jashtëm të mësimit me bazë punën u organizua me sukses më datat 17 dhe 18 tetor në Kishinau, Republika e Moldavisë.

Në këtë diskutim fokus kryesor ishte sigurimi i cilësisë së mësimit me bazë punën përmes sistemit të vlerëimit të jashtëm. U shqyrtuan mënyrat në të cilat vlerësimi i jashtëm mund të kontribuojë në cilësinë e mësimit me bazë punën, duke marrë në konsideratë rrethanat kombëtare, autoritetet, përgjegjësitë dhe mandatet.

Në takim ishin pjesëmarrës përfaqësues të institucioneve përkatëse nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Moldavia, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, duke përfshirë përfaqësues të qendrave të AFP-së, Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë, përfaqësues të sektorit të biznesit, si dhe ekspertë që angazhohen me mësimin me bazë punën.

Më herët gjatë projektit EQET SEE, u shpreh interesi nga organet e vlerëimit të jashtëm për të eksploruar vlerësimin e jashtëm të mesimit me bazë punën dhe për të sugjeruar përmirësime. Paraprakisht, për përmirësimin e mëtejshëm, janë shqyrtuar Kornizat e vlerëimit të jashtëm për çdo ekonomi dhe janë përgatitur grupi rajonal i treguesve për AFP-në dhe mësimin me bazë punën dhe më pas janë diskutuar gjatë këtij takimi. Delegacionet nga ekonomitë e Evropës Juglindore dhe Moldavia konsideruan gjithashtu me këtë rast se si instrumentet e zhvilluara mund të përdoren më së miri në sistemet kombëtare. Këto dokumente do të shërbejnë si përgatitje për punë të mëtejshme kombëtare mbi metodologjitë e AFP-së, si dhe vlerësim cilësor të mësimit me bazë punën.





<https://akafp.gov.al/blog/2023/09/19/takimi-i-rradhes-i-projektit-eqet-see/>